

UDHËZIM
Nr.9, datë 2.5.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.22, DATË 12.10.2010 “PËR PROCEDURAT E SHITJES SË OBJEKTEVE TË MIRATUARA PËR PRIVATIZIM SIPAS VENDIMIT NR.676, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-QYTETIT TË NXËNËSVE, PRANË SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE, TIRANË”, VENDIMIT NR.678, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI, TIRANË, DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË”, VENDIMIT NR.708, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-KONVIKTIT DHE TË SHKOLLËS KOMUNALE, TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI”, VENDIMIT NR.1285, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E ISH-OBJEKTIT TË KURSIT TË NDËRLIDHJES SË PTT-SË, TIRANË, NGA ISH-MINISTRIA E EKONOMISË DHE PRIVATIZIMIT, SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI”, VENDIMIT NR.601, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIM OJBKTESH NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OJBKTTT ISH-KOPSHTI NR.26, NË TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI””

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit 9232 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, vendimit nr.310, datë 21.4.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kostos mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, të periudhës 2009-2011”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit “Për procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizim sipas vendimit nr.676, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë”, të vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë”, vendimi nr.708, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe

Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi”, vendimi nr.1285, datë 23.12.2009 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin e ish-objektit të Kursit të Ndërlidhjes së PTT-së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, të vendimit nr.601, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kalim objektesh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-Kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi”, të bëhet një ndryshim si vijon:

Në pikën 4. Vlera totale e privatizimit të banesës, përmbajtja e koeficientit “K”, të ndryshojë në:

“..K- është kostoja lekë/m² për sipërfaqen e ndërtimit të objektit, referuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 21.4.2011 “Për përcaktimin e koston mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues të Këshillit të Ministrave.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi